



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Illir Halili	05.06.2026	15.06.2026	2026/0362

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 04.06.2026, OE “Naim Shuki B.I.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0362, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “FWRDZ L.L.C”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME FLAMUJ TË POLICISË SË KOSOVËS DHE FLAMUJ SHTETËRORE” me nr. të prokurimit: “214/30400-26-2218-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 35,000€. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti 1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që

fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në

mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. 2. Autoriteti kontraktues

nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Neni 1 i LPP-së Qellimi

Neni 59 i LPP-së Ekzamini vlersimi dhe krahasimi tendereve

Neni 60 i LPP-së Kriteret për dhenjen e kontrates 3/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit ne

AK

Neni 59 i LPP-së aftesit teknike dhe/ose profesionale

Pasi kemi pranuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK) dhe pas qasjes në dokumentacionin e tenderit dhe në mostrat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik (OE) i rekomanduar për shpërblim me kontratë, kemi identifikuar shkelje të rënda të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) Nr. 04/L-042, rregullave dhe udhëzuesve në fuqi, si dhe të vetë Dosjes së Tenderit (DT).

Gjetjet, argumentet dhe arsyetimi ligjor pasqyrohen si në vijim:

I. Shkelja e Nenit 69 të LPP-së (Aftësia Teknike dhe Profesionale) dhe

Ndryshimi i Kushteve të DT-së përmes "Sqarimeve"

Gjatë vlerësimit të ofertave, AK është bazuar në një "sqarim" të bërë për një OE dhe këtë sqarim e ka përdorur si bazë për të eliminuar operatorin "Naim Shuki BI"

? -Përmes këtij sqarimi, AK ka bërë ndryshime dhe shtesa të kriterëve që nuk figurojnë fare në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit apo në Njoftimin për Kontratë.

? -Sipas Nenit 69 të LPP-së, AK nuk ka të drejtë të shtojë apo ndryshojë kriteret e përzgjedhjes në fazën e sqarimeve pa bërë korrigjimin zyrtar të gabimeve dhe pa njoftuar të gjithë OE-të në mënyrë të barabartë përmes përmirësimit të Dosjes së Tenderit (Aneksit 1). Ky veprim e bën procesin e vlerësimit të paligjshëm.

II. Shkelja e Udhëzuesit Operativ Nr. 002/2024 (Favorizimi i OE-së të papërgjegjshëm)

Në Dosjen e Tenderit (Kapaciteti teknik dhe profesional, Kërkesa 1), është kërkuar në mënyrë taksative: "Operatori Ekonomik duhet të ofrojë katalog, broshurë ose foto me përshkrim detal të produkteve me të cilat mundësohet vlerësimi i specifikacioneve teknike."

? -OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kusht në ofertën e tij fillestare.

? -Duke u bazuar në UDHËZUESIN Nr. 002/2024 (Për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik), AK kishte për obligim ta eliminonte dhe ta refuzonte këtë tender pa kërkuar informacione të mëtejshme.

? -Përkundër kësaj, AK në mënyrë të paligjshme dhe selektive ka kërkuar informacion të mëtejshëm për katalogun me datë 08.05.2026, duke shkelur rregullat e specifikuara në Udhëzuesin në fuqi.

?

Bashkangjitur ne Dokumente PDF (Udhzim Administrativ 002.2024)

III. Shkelja e Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi) – Standardet e Dyfishta të "Lidhëset"

Në Aneksin 1 të DT-së, për flamujt me numër 1, 3, 5 dhe 6, kërkohej në mënyrë specifike që produkti "duhet të ketë lidhëse për lidhjen e flamurit".

? -Gjatë qasjes në mostra, është vërtetuar se OE i rekomanduar (me çmim më të lartë) ka vendosur VARËSE dhe jo lidhëse, gjë që e bën këtë tender të papërgjegjshëm.

? -Ndërsa, OE "Naim Shuki BI" është eliminuar nga komisioni i vlerësimit me të njëjtin arsyetim (për shkak të varësive në Vendimin Autoriteti Kontraktues publikuar me datë 21.05.2026).

? -Kjo përbën një shkelje të hapur të Nenit 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim), pasi

AK ka aplikuar kritere të dyfishta: ka eliminuar një OE dhe ka shpallur përgjegjës një OE tjetër për të njëjtin devijim teknik.

IV. Mospërputhjet Dimensionale dhe Teknike të Mostrave (Tejkalimi i Tolerancës 1%) VAK(VendiminAutoritetiKontraktues publikuar me date 21.05.2026)

Gjatë qasjes në mostrat e OE-së të rekomanduar për kontratë, janë matur dhe konstatuar devijime që kalojnë kufirin e tolerancës prej 1% të përcaktuar nga vetë AK-ja në Dosjen e Tenderit:

1. Flamuri Shtetëror i madh për Ballkone (Pozicioni 1): Harta e Kosovës në pjesën e poshtme është 24 cm dhe e lartë 50 cm, kurse yjet janë 27 cm. Harta është vendosur shumë poshtë dhe jo në mënyrë proporcionale. Dimensionet e flamurit kanë devijim prej 3 cm (mbi 1%). Ka dallime të qarta mes pjesës së poshtme dhe asaj të lartme (Për këtë pikë, sipas VAK-ut, OE Naim Shuki është eliminuar, që tregon sërish trajtim jo të barabartë).

1. 2. Flamuri Shtetëror i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 2):

Dimensioni i kërkuar 107 cm – dimension i dorëzuar 105 cm (Devijim prej 2 cm, kalon tolerancën 1%).

2.

1. 3. Flamuri Shtetëror i vogël për Ballkone (Pozicioni 3): Dimension i kërkuar 150 cm – dimension i dorëzuar 153 cm (Devijim prej 3 cm, kalon tolerancën 1%).

2.

3. 4. Flamuri i PK-së i madh për Ballkone (Pozicioni 5): Dimension i kërkuar 280 cm – dimensionet e dorëzuara janë 284 cm, 285 cm dhe 197 cm (Devijim prej 3 cm deri në 5 cm, kalon dukshëm tolerancën 1%).

4.

1. 5. Flamur i PK-së i mesëm për përdorim të brendshëm (Pozicioni 7):

Dimensioni i kërkuar 107 cm – dimensionet e dorëzuara janë 104.5 cm dhe 105 cm (Devijim prej 2 cm deri në 2.5 cm, kalon tolerancën 1%).

2.

3. 6. Flamur i PK-së i vogël për Tavolinë (Pozicioni 8): Për dimensionin e kërkuar

Gjerësia 16 cm / Gjatësia 23 cm, mostra e dorëzuar nuk është asimetrike.

Gjatësia në pjesën e epërme është 23 cm, në mes 23.3 cm, ndërsa në pjesën e poshtme 22.7 cm. Ky devijim strukturor e bën produktin jashtë specifikave.

V. Mospërputhja e Ngjyrës së Flamujve me Kodin e Kërkuar CMYK

Në Aneksin 1 të DT-së, është kërkuar në mënyrë strikte ngjyra Verdhë (ARI) me kodin: CMYK-Ari: 0-20-62-18.

? - Flamujt me numra 1, 3, 5 dhe 6 kanë dallime të theksuara në nuancë me flamujt me numra 2, 4, 7 dhe 8.-

? - Flamujt 2, 4, 7 dhe 8 të dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk e posedojnë ngjyrën e kërkuar Verdhë (ARI) sipas kodit CMYK, por janë prodhuar me ngjyrë të verdhë të thjeshtë me numër krejtësisht ndryshe nga kërkesa e DT-së.

PËRFUNDIM

Bazuar në të gjitha gjetjet e mësipërme (të cilat i dëshmojmë edhe përmes fotografive të bashkangjitura të realizuara gjatë qasjes në mostra), Operatori Ekonomik i rekomanduar nga AK është plotësisht i papërgjegjshëm.

I kërkojmë OSHP-s që të aprovojë si të bazuar këtë Ankesë, të anulojë njoftimin për dhënie të kontratës dhe ta kthejë lëndën në rivlerësim në përputhje të plotë me LPP-në.

1.

2. 1. Të aprovojë si të bazuar këtë Ankesë.

3. 2. Të anulojë Vendimin mbi dhënien e kontratës.

4. 3. OSHP-ja të kryejë vizitë në Autoritetin Kontraktues (AK) për verifikimin dhe vlerësimin e mostrave të dorëzuara.

5. 4. Mostrat të kontrollohen në mënyrë strikte dhe objektive sipas kriterëve të DT-

së.

KRITERET PËR VLERËSIM

Dosja e Tenderit dhe Sqarimet e dhena nga AK

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

Përgjigjja ne pretendimet ankimore te OE Naim Shuki B.I.

- **AK nuk ka shkelur Nenin 1 Qëllimi i LPP-së** , sepse autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi qëllimin e këtij ligji që është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, dhe të siguroj integritet dhe përgjegjësi të zyrtarëve përgjegjës, transparencë dhe jo diskriminim pasi AK ka publikuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit me procedurë të hapur duke mos vendosur asnjë kriter apo specifik e cila do të kishte pamundësuar aplikimin e ndonjë OE, andaj ky pretendim ankimore është i pabazuar.
- **AK nuk ka shkelur Nenin 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti**, sepse autoriteti kontraktues ka respektuar në tërësi qëllimin e këtij ligji që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës, andaj ky pretendim ankimore është i pabazuar
- **Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**
Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, ku te gjithë OE pjesëmarrës ne

këtë aktivitet të prokurimit duke ju përfshirë edhe juve si ankues i ka trajtuar në mënyrë të barabartë pa diskriminime dhe pa favorizime të asnjë OE, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik. Oferta e juaj është e papërgjegjshëm pasi që nuk i keni plotësuar specifikat teknike përkatësisht mostrat e dorëzuar nga ana juaj nuk janë në harmoni me aneksin 1 të dosjes së tenderit, andaj ky pretendim ankimore është i pabazuar.

- **AK nuk ka bërë shkelje të nenit 59 pasi në harmoni të plot me nenin 59 të LPP-së**
AK ka bërë vlerësim ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave sipas kërkesave në Dosjen e tenderit dhe Njoftimit për kontratë dhe sipas specifikave teknike të detyrueshme në aneksin 1.
- **AK nuk ka bërë shkelje të nenit 60 pasi në harmoni të plot me nenin 60 të LPP-së nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kritereve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë si dhe sipas specifikacioneve teknike të kërkuar në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Ju si ofertues nuk i keni plotësuar specifikacionet teknike dhe jeni ofertues i pa përgjegjshëm.**
- **AK nuk ka bërë shkelje të nenit 69 pasi në harmoni të plot me nenin 69 të LPP-së nuk qëndron nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje pasi që në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë është kërkuar të sillen mostrat. Gjate fazës së publikimit AK-Policia e Kosovës me datën 23.04.2026 ka pranuar kërkesën për Sqarime shtese. Kërkesë kjo e trajtuar nga hartuesit e specifikacioneve teknike .Me datën 24.04.2026 kemi pranuar sqarimet shtese dhe të njëjtat sqarime janë ngarkuar në Sistemin e E-prokurimit tek Sqarimet e Dosjes së Tenderit qasje kjo për të gjithë OE e interesuar në këtë procedure të prokurimit,**
- **AK nuk ka bërë ndryshime në specifikacione teknike dhe për këtë arsye nuk është bërë korrigjimi i DT , andaj ky pretendim ankimor nuk qëndron. Shih me poshtë Pyetjet dhe Përgjigjet e ngarkuara në Sistem.**

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Naim Shuki B.I.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë sipas ankesës 362/26 është se:

"Gjatë vlerësimit të ofertave, AK është bazuar në një "sqarim" të bërë për një OE dhe këtë sqarim e ka përdorur si bazë për të eliminuar operatorin "Naim Shuki BI"

- *-Përmes këtij sqarimi, AK ka bërë ndryshime dhe shtesa të kriterëve që nuk figurojnë fare në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit apo në Njoftimin për Kontratë.*
- *-Sipas Nenit 69 të LPP-së, AK nuk ka të drejtë të shtojë apo ndryshojë kriteret e përzgjedhjes në fazën e sqarimeve pa bërë korrigjimin zyrtar të gabimeve dhe pa njoftuar të gjithë OE-të në mënyrë të barabartë përmes përmirësimit të Dosjes së Tenderit (Aneksit 1). Ky veprim e bën procesin e vlerësimit të paligjshëm."*

Megjithatë OE ankues nuk jep sqarime të mëtutjeshme se cilat janë ato kërkesa të dosjes së tenderit të cilat nuk përkojnë me kërkesat/sqarimet e dhëna nga ana e AK-së, dhe menjëher pas kësaj OE ankues lëshohet në pretendimet kundrejt ofertë së OE të rekomanduar për kontratë.

Bazuar në këto që u cekën më lartë, eksperti shqyrtues mendon se OE ankues nuk ka ofruar prova konkrete për të mbështetur pretendimin e tij se kemi të bëjmë me ndryshim të kriterëve përmes sqarimeve, pa e bërë korrigjimin e gabimeve në dosje të tenderit, andaj japim mendim se pretendimi ankimorë është i pabazuar.

Pretendimi nr.2

OE ankues në vazhdim ka një mori pretendimesh ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, konkretisht se se mostrat e ofruara nga OE fitues janë kundërshtim me një numër të të caktuar të specifikave teknike.

Eksperti shqyrtues i OSHP-së sqaron se, përderisa në shumë raste analizimi i mostrave nga vet eksperti mund të jetë i mjaftueshëm për ekspertin që të arrijë në një konkluzion/vlerësim, këto raste sipas mendimit të ekspertit janë të një natyre më pak komplekse, psh.. kur kemi të bëjmë me mungesën e një etikete, ose dallim substancial i ngjyrës së kërkuar dhe asaj të ofruar, ose dallim substancial i dizajnit/formës dhe llojit të qepjes etj.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me probleme më komplekse, ku pretendimet ankimore kanë të bëjnë me dimensionet fizike të mostrave dhe elementeve/detajeve të ndryshme brenda vet mostrës dhe proporcionaliteti të këtyre elementeve në mes vete, çështje këto të cilat sipas mendimit tonë eksperti shqyrtues nuk ka as kapacitet profesional/teknik për ti matur/vlerësuar, e nuk ka as kompetencë/autorizim për të bërë një vlerësim/matje të tillë.

Mendimi i ekspertit është se për tu përgjigjur në pretendime të tilla ankimore matjet mund të bëhen vetëm nga ndonjë laborator i akredituar për të bërë matje të tilla apo ndonjë insitucion kompetent, andaj rekomandimi i ekspertit është që lënda të kthehet në rivlerësim dhe mostrat e OE-ve të dërgohen pranë një laboratorit të akredituar për matje të tilla, apo pranë ndonjë institucioni vendor kompetent.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Naim Shuki B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME FLAMUJ TË POLICISË SË KOSOVËS DHE FLAMUJ SHTETËRORË**” me numër të prokurimit: “214/30400-26-2218-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksporti shqyrtues i rekomandon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim me qëllim të dërgimit të mostrave në laborator për testim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Naim Shuki B.I.", lidhur me aktivitetin e prokurimit
"FURNIZIM ME FLAMUJ TË POLICISË SË KOSOVËS DHE FLAMUJ SHTETËRORË" me numër të prokurimit:
"214/30400-26-2218-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Naim Shuki B.I.**



Ilir Halili